



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1957  
Dt 18.10.2019

Në bazë të nenit 28, pika 1.5, të Statutit të Përkohshëm, rektori i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, merr:

**VENDIM**

- I. Ass. Zahir Çerkini, asistent në Fakultetin Juridik, emërohet koordinator qendror për zhvillim akademik të UMIB-it, duke filluar nga data 18.10.2019.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit qendror për zhvillim akademik janë:
  - Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e akreditimit institucional dhe të akreditimit të programeve, përfshirë udhëzimin në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, si raportin e vetëvlerësimit, planin për zbatimin e rekomandimeve, raportin e progresit për zbatimin e rekomandimeve etj;
  - Koordinon punët e zyrës me Senatin e UMIB – it, Këshillin Drejtues, njësitë akademike, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura;
  - Në bashkëpunim me menaxhmentin e UMIB – it, përkatësisht me prorektorin për mësim dhe kërkime shkencore dhe me prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë, si dhe me aktorët e tjerë relevantë përkrah promovimin dhe zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Procesi i Bolonjës;
  - Nën udhëheqjen e prorektorit për mësim dhe kërkime shkencore dhe prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë, e përpilon planin e punës së Zyrës dhe e mbikëqyr realizimin e tij;
  - I përcjell rrjetet dhe trendët ndërkombëtarë të arsimit të lartë dhe kujdeset që të njëjtat t’ua përcjellë strukturave gjegjëse të UMIB – it;
  - E udhëheq rrjetin e koordinatorëve për zhvillim akademik të fakulteteve;
  - I përcjell rrjetet dhe trendët ndërkombëtarë të kërkimeve shkencore dhe kujdeset që të njëjtat t’ua përcjella strukturave gjegjëse të UMIB – it;
  - E përfaqëson Zyrën për shkencë, zhvillim akademik dhe cilësi në takime, në komisione dhe në organizime të tjera zyrtare brenda dhe jashtë Universitetit të Mitrovicës;
- III. Të përmendurit i takon kompensimi për ushtrimin e detyrës së koordinatorit qendror për zhvillim akademik në bazë të Rregullores për të ardhura personale në UMIB.

Vendimi t’i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Zyrës së personelit;
4. Shërbimit financiar.



Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it

